



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

PROFILI GJINOR I KOSOVËS: BUJQËSIA DHE JETESA RURALE

PËRMBLEDHJE E METODOLOGJISË

PARATHËNIE

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO) është duke e zbatuar projektin rajonal të alokimit "Vlerësimi i bujqësisë digjitale, gjinisë dhe rinisë në Kosovën rurale për gjithëpërfshirjen ekonomike". Projekti synon të rrisë njohuritë për gjendjen e digjitalizimit dhe çështjet gjinore në Kosovë. Qëllimi është të propozohen rekomandime specifike strategjike drejt sistemeve të qëndrueshme dhe transformuese agro-ushqimore dhe fuqizimit të grave në sektorin e bujqësisë, duke përfshirë strategji të përgjegjshme gjinore. Rekomandimet e bazuara në fakte do të synojnë të çojnë përpara barazinë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave në bujqësi, zhvillimin rural, si dhe të informojnë strategjitë digjitale gjithëpërfshirëse. "Profili Gjinor i Kosovës për Bujqësinë dhe Jetesën Rurale" do të publikohet për të integruar gjetjet dhe për të adresuar boshllëqet në të dhënave mbi çështjet gjinore.

FAO ka bashkëpunuar me Rrjetin e Grave të Kosovës (RrGK) në përgatitjen e Profilit Gjinor të Kosovës për Bujqësinë dhe Jetesën Rurale, duke ndjekur metodologjinë e FAO-s për përgatitjen e Vlerësimeve Gjinore të Vendit (CGA). Profili do të përfshijë analizën gjinore të kornizës ligjore, njohurive, pronësisë së tokës, qasjes dhe kontrollit mbi burimet, pjesëmarrjes në aktivitetet formale dhe joformale të gjenerimit të të ardhurave, vendimmarrjes në bujqësi si dhe në fusha të tjera relevante. Një analizë e tillë gjinore mund t'i informojë politikat e qeverisë si dhe investimet e BE-së dhe financuesve të tjerë në lidhje me sektorin e bujqësisë, e veçanërisht në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE. Më specifikisht, kjo analizë synon të informojë Strategjinë Qeverisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2021-2028, si dhe Agjendën Digjitale të Kosovës. Analiza është nxjerrë nga udhëzimet e [Manualit për Vlerësimin e Ndikimit të Barazisë Gjinore të Agjencisë për Barazi Gjinore](#).

Kjo analizë është përgatitur në konsultim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Iniciativën për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë (IADK). RrGK është duke e zbatuar këtë analizë, me financimin e FAO-s. Ky dokument përmbledh metodologjinë e hulumtimit.

QËLLIMET / OBJEKTIVAT

Qëllimi i përgjithshëm i këtij hulumtimi është që të kontribuojë në Objektivin Strategjike të FAO-së 2018-2021 "Ulja e varfërisë rurale", duke synuar përmbushjen e Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Rezultati i pritur është: "Përgatitja e vlerësimit dhe rekomandimeve për avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave në bujqësi dhe zhvillim rural, dhe hartimi i një kornize për strategjinë digjitale gjithëpërfshirëse në Kosovë". Nga ky hulumtim pritet që të përmirësohen njohuritë dhe të identifikohen të gjetura në lidhje me situatën e barazisë gjinore në Kosovë. Pyetjet kërkimore të hulumtimit janë formuluar duke u bazuar në gjetjet primare. Këto pyetje do të adresohen përmes metodave të kërkimit të përshkruara në pjesën në vazhdim.

METODOLOGJIA

Pyetjet hulumtuese

Pyetja e përgjithshme hulumtuese është: Deri në çfarë mase qasja e grave dhe burrave të ndryshëm në burime, besime dhe perceptime, praktika dhe pjesëmarrje si dhe fuqi të tjera të ngjashme ndikon në përfshirjen aktive të tyre në punën prodhuese, kohë-kursyese bujqësore dhe gjenerim të të ardhurave? Nënpyetjet e ngjashme të hulumtimit do të synojnë t'i përgjigjen secilës prej qëllimeve. Ato përfshijnë:

- 1.1. Si dallon përfshirja e grave dhe burrave të ndryshëm në punën e papaguar, duke përfshirë punën bujqësore në fermat familjare?
- 1.2. Si dallon shfrytëzimi i kohës nga burrat dhe gratë në një ekonomi familjare të zonave rurale?
2. Deri në çfarë mase gratë dhe burrat e ndryshëm të zonave rurale kanë qasje në infrastrukturën dhe teknologjinë prodhuese dhe për kursimin e kohës?
3. Cilat janë perceptimet e grave të zonave rurale për mundësitë e fitimit të të ardhurave?
- 4.1. Deri në çfarë mase gratë dhe burrat e ndryshëm kanë digjitalizuar punën e tyre në ekonomitë rurale?
- 4.2. Cilat janë sfidat me të cilat gratë e zonave rurale përballen sa i përket qasjes në infrastrukturë prodhuese dhe për kursimin e kohës, teknologji dhe mundësi të gjenerimit të të ardhurave, duke përfshirë këtu edhe ato sfida që lidhen me digjitalizimin?
5. Si ka ndikuar COVID-19 në prodhimin bujqësor dhe aktivitetet e gjenerimit të të ardhurave, si dhe në punën e kujdesit në nivel të ekonomisë familjare?
6. Deri në çfarë mase gratë e zonave rurale kanë qasje në rrjete të mbështetje, në mundësitë për lidhshmëri si dhe në jetën jashtë shtëpisë?

Metodat e Kërkimit dhe Burimet e të Dhënave

Hulumtimi do të përdorë metoda të përziera të cilat kontribuojnë në vlefshmërinë e gjetjeve përmes trekëndëzimit të studiuesve dhe gjetjeve që dalin nga përdorimi i metodave dhe burimeve të ndryshme të të dhënave. Metodat do të përfshijnë:

- Shqyrtim i literaturës ekzistuese, të dhënave dhe statistikave institucionale.
- Kryerja e një ankete gjithëpërfshirëse në 803 ekonomi familjare rurale në mbarë Kosovën, duke përfshirë gra dhe burra të të gjitha etnive nga 38 komunat e Kosovës. Anketa do të përdorë metodologjinë e FAO-së, si dhe disa pyetje nga Eurostat-i dhe Instituti European i Barazisë Gjinore që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e kohës, punës, shëndetit dhe sigurisë në punë. Kështu duke mundësuar krahasimin me vendet e tjera.
- Diskutime në fokus grupe me gra dhe burra të ndryshëm në zona të ndryshme.
- Intervista të thella me të paktën 20 gra që përfaqësojnë regjione, komuna, mosha, dhe grupe etnike të ndryshme të Kosovës. Intervistat me informantë kyç do të realizohen me zyrtarë relevantë të niveleve lokale dhe nacionale; organizata të shoqërisë civile; si dhe njohës të ekonomisë rurale, bujqësisë dhe të digjitalizimit.

Anketa me ekonomitë familjare do të realizohet në mars të vitit 2022, kurse analiza gjinore do të përfundojë në qershor të vitit 2022.

KONTAKTI

Për më shumë informata rreth analizës gjinore ose metodologjisë së plotë, ju lusim ta kontaktoni Nicole Farnsworth, Drejtore e Programit dhe Udhëheqëse e Hulumtimeve në RrGK: nicole@womensnetwork.org.